



Kuvendi i Komunës Klinë

01/ Nr prot. 06-32570 /2025

Datë: 25.09 /2025

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 shkronjën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Kornizën Afatmesme 2026-2028, nenin 40 paragrafi 2 nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 09.09.2025 dhe debatin me publikun më 16.09.2025, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII- të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më 19.09.2025 mori këtë:

V E N D I M

Për

Aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2026, përfshirë projektet kapitale

1. Miratohet buxheti i Komunës së Klinës për vitin **2026**, duke përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe projekteve kapitale.
2. Buxheti i përgjithshëm për vitin **2026** është në shumë totale prej **16,338,898 €**.
3. Buxheti përfshin:
 - a) Shpenzime të rregullta funksionale të institucioneve të Komunës;
 - b) Shpenzime kapitale për projekte me prioritet në infrastrukturë, arsimin, shëndetësinë, ambientin dhe shërbimet publike.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është buxheti i miratuar së bashku me projektet me prioritet për vitet **2026, 2027 dhe 2028** të cilat janë përfshirë në buxhet.
5. Kompetent për zbatimin e këtij vendimi janë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Kryetari i Komunës është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të projekteve dhe respektimin e buxhetit të miratuar.
7. Ky vendim hyn në fuqi **30** ditë pas dërgimit te autoriteti mbikëqyrës (MAPL), bazuar në Ligjin **Nr.08/L-284**, dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
01Nr. 06-32570 /2025
Datë: 25.09 /2025

BUXHETI KOMUNAL I KOMUNËS SË KLINËS

2026-2028

(SYNIMET – OBJEKTIVAT SIPAS DREJTORIVE)

Shtator / 2025

Zyra e Kryetarit

Kryetari: Zenun Elezaj

Deklarata e misionit: Të ofrojë udhëheqje efektive dhe të përgjegjshme, rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, promovimin e transparencës për të arritur rezultatet që avancojnë interesin e qytetarit, duke bërë mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdesit për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të komunës.

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL-së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

1. Mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të Komunës,
2. Mbikëqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të miratuara nga Kuvendi i Komunës,
3. Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës,
4. Emëron dhe shkarkon nënkryetarin/en e Komunës,
5. Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës,
6. I propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionimin dhe numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi,
7. I propozon Kuvendit të Komunës konstituimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve,
8. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës,
9. Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së pakut një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës (neni 58 nenë (j) i LVL-e),
10. Paraqet planin e punës dhe raportin vjetor,
11. Emëron dhe shkarkon drejtorët e drejtorive përkatëse komunale (neni 62 pika 62.2 të LVL-së),
12. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo Komiteteve të tij,
13. Kryen edhe aktivitetet e tjera që i caktohen me nenin 58 të LVL-së, dhe Statutit të Komunës.

Deklarata e vizionit: Të krijojë një komunë moderne, të zhvilluar dhe të qëndrueshme, ku qytetarët janë të angazhuar dhe të informuar. Ofrimin e shërbimeve sa më cilësore ndaj qytetarëve, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të komunës në përgjithësi, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj. Avancimi dhe i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna mbesin ndër vizionet e komunës për vitet e ardhshme.

Deklarata e Qëllimit: Të sigurojë një administratë komunale që funksionon në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme, duke u fokusuar në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e shërbimeve publike dhe forcimin e demokracisë lokale përmes transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare. Ngritja e nivelit të mirëqenies sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim

Deklarata e Synimit:

- Udhëheqje efektive dhe transparente: Të sigurohet një administratë komunale që funksionon në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e administratës.
- Përmirësimi i shërbimeve publike: Të ofrohen shërbime publike të cilësisë së lartë për qytetarët, duke siguruar akses të barabartë dhe të drejtë për të gjithë.
- Zhvillimi ekonomik dhe social: Të krijohen mundësi për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të kushteve sociale për të gjithë qytetarët, duke inkurajuar investimet dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Angazhimi qytetar dhe pjesëmarrje: Të inkurajohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të sigurohet një komunikim i hapur dhe i ndershëm me komunitetin.

Performanca :

Kategoritë ekonomike		2026	2027	2028
1	Paga dhe medijtje	238,318.79	238,318.79	238,318.79
2	Mallra dhe shërbime	16,000.00	16,000.00	16,000.00
3	Komunali	-		
4	Subv. dhe trans fere	292,000.00	292,000.00	292,000.00
5	Kapitale			
	TOTALI	546,318.79	546,318.79	546,318.79
	Numri i te punesuarve	21	21	21

	2026	2027	2028
Kuantitative			
Përgatitja e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale (nxjerrja e Rregulloreve ,Vendimeve, Udhëzimeve etj) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mirë të gjitha Drejtorive të KK. gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike te planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike te planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike te planit vjetor
Kualitative			
1. Kuvendi gjatë vitit kalendarik planifikon t`i mbajë 11 mbledhje të rregullta- obligative	11	11	11
2. KPF, po ashtu, 11 mbledhje obligative.....	11	11	11
3.bordi i Drejtorëve planifikon t`i mbajë 48 mbledhje të rregullta.	48	48	48

Zyra e Kuvendit Komunal

Kryesuesi : Fadil Gashi

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal, të përcaktuar me LVL – në dhe Statutin e Komunës.

Kuvendi i Komunës ka 27 antarë .

Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi për fushat në vijim:

- a) Miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e Statutit, Rregullores së punës dhe rregulloreve komunale,
- b) Miratimin e buxhetit dhe të planeve investuese;
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- d) Raportin vjetor;
- e) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- f) Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete dhe nënkryetarit për komunitete;
- g) Nivelin e taksave, tarifave dhe gjobave komunale;
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- j) Arritjen dhe miratimin e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- k) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Deklarata e vizionit: Të jetë një zyrë e fuqishme dhe e besueshme, që promovon transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe zhvillimin e politikave të qëndrueshme për komunën. Për të siguruar shqyrtimin në kohë dhe Miratimin e politikave dhe rregulloreve komunale dhe planeve statutores, duke përfshirë buxhetin, në një mënyrë e cila i lejon ekzekutivit dhe stafit të komunës për të kryer detyrën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Për të siguruar politikë të përshtatshme dhe plane brenda fushë veprimit të kompetencave të komunës, duke i respektuar të gjitha ligjet, në një mënyrë që përfitimet e qytetarëve të jenë të mëdha.

Deklarata e Qëllimit:

1. **Sigurimi i mbështetjes administrative dhe logjistike për Kuvendin dhe deputetët:** Ofrimi i shërbimeve të nevojshme për funksionimin e Kuvendit dhe për realizimin e detyrave të deputetëve.
2. **Përmirësimi i kapaciteteve të administratës së Kuvendit:** Zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe teknike të stafit të administratës për të ofruar shërbime efikase dhe efektive.
3. **Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe ndërkombëtare:** Avancimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera për të siguruar një legjislacion të cilësisë së lartë dhe për të promovuar proceset demokratike.

4. **Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies:** Sigurimi i një administrate të hapur dhe të përgjegjshme, ku qytetarët kanë mundësi të informohen dhe të angazhohen në proceset vendimmarrëse.

Performanca :

Kategoritë ekonomike		2026	2027	2028
1	Paga dhe medijtje	297,195.48	297,195.48	297,195.48
2	Mallra dhe shërbime	5,000.00	5,000.00	5,000.00
3	Komunali			
4	Subv. dhe transfere			
5	Kapitale			
	TOTALI	302,195	302,195	302,195
	Deputetet e Asamblesë komunale	27	27	27

Deputetet e Asamblesë komunale	27	27	27
--------------------------------	----	----	----

	2026	2027	2028
Kuantitative			
Kuvendi i Komunës dhe organet e tij (komitetet e përhershme dhe ato ad hoc), me subjektet relevante të nivelit qendror dhe ato lokal, OJQ-të, bizneset etj, ka qëllim ofrimin sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve, angazhohet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës sonë, duke përfshirë këtu ndërmarrjen edhe të aktiviteteve tjera të domosdoshme për kujdesin që qytetarët e Komunës të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim.	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor	Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor
Kualitative			
1. Kuvendi gjatë vitit kalendarik planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta-obligative.....	12	12	12
2. KPF po ashtu 12 mbledhje obligative.....	12	12	12

Administrata dhe personeli

Drejtori: Binak Syla

Deklarata e misionit: Të menaxhojë burimet njerëzore të administratës publike lokale, duke zbatuar politikat e shërbimit civil, duke siguruar rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit, dhe duke garantuar një mjedis pune të drejtë dhe të barabartë.

Deklarata e Vizionit: Të krijojë një administratë publike të aftë, të motivuar dhe të përgjegjshme, që ofron shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe transparencën e administratës lokale. Të sigurojmë mbështetje administrative dhe këshilla për të gjitha drejtoritë tjera komunale dhe Kuvendin për të ju mundësuar atyre që t'i arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Për të përmirësuar transparencën për qytetarët tanë, ne mirëmbajmë dhe e freskojmë rregullisht faqen e internetit të komunës.

Deklarata e Qëllimit: Menagjimi me një nivel të lartë të gjithë administratës komunale, ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët.

Performanca :

ADMINISTRATA DHE PERSONELI

	Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1	Paga dhe medijtje	341,028.56	341,028.56	341,028.56
2	Mallra dhe shërbime	80,500.00	80,500.00	80,500.00
3	Komunalit			
4	Subven. dhe transf.	4,000	4,000	4,000
5	Kapitale	55,000.00	35,000	85,000
	TOTALI	480,528.56	460,528.56	510,528.56
	Numri I te punesuarve	39	39	39

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1. Do të lëshohen certifikata të gjendjes civile	20.000	41.000	42.000
2. Pranimi kërkesave, ankesave parshtrësive etj	12.000	13.000	14.000
Kualitative			
1. Puna rreth certifikatave do të bëhet sipas programit Unik të Kosovës , ku do të kemi një përmirësim të kualitetit në shërbimet e karakterit civil	90%	95%	95%

Inspeksioni

Drejtori: Faruk Smajli

Deklarata e Misionit: Zbatueshmëria e Ligjit nga ana e të gjitha sektorëve të Inspeksionit.

Deklarata e Vizionit: Misionit: Administrata siguron të gjitha procedurat, udhëzimet dhe politikat për implementimin sa më të mirë të aktiviteteve të kësaj drejtorie, menaxhon me stafin, Inspektorët, buxhetin dhe financat e kësaj drejtorie.

Deklarata e Qëllimit: Arritja e efikasitetit të gjithë Sektorëve të Inspeksionit , azhuritit dhe respektimit,dhe implementimit të dispozitave ligjore me përpikëri

Performanca :

Kategoritë buxhetore	2026	2027	2028
1 Paga dhe medijtje	88,840.00	88,840.00	88,840.00
2 Mallra dhe shërbime	32,000.00	32,000.00	32,000.00
3 Komunalit			
4 Subven. dhe transf.			
5 Kapitale	-		
TOTALI	120,840.00	120,840.00	120,840.00
Numri i te punesuarve	8	8	8

	2026	2027	2028
Kuantitative			
11. Do të përgatiten raportet mujore, 6 mujore dhe vjetore.....	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit
3. Do te shpërndahen, njoftime, kontrolle për sugjerime për të gjitha punët për ligjet e aplikueshme.....			
Kualitative			
1. 1. Detyra për raportet e punës, realizimi i inkasimit të taksave.....	90%	90%	95%
2. Shpërndarja e vazhdueshme ne realizimin e të hyrave.....	95%	96%	97%
3. Aksionet për inkasim të përbashkët me drejtoritë tjera.....	90%	90%	95%
4. Inkasimi i të hyrave për DPU dhe R.			

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtori: Enver Berisha

Deklarata e misionit: Të angazhohet në menaxhimin efikas dhe transparent të burimeve financiare të komunës, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ajo kontribuon në përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbikëqyrjen e shpenzimeve, inkasimin e të hyrave dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës.

Deklarata e vizionit: Të krijohet një komunë me menaxhim të qëndrueshëm dhe transparent të financave publike, ku burimet financiare shfrytëzohen në mënyrë efikase për të mbështetur zhvillimin ekonomik, përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Drejtoria synon të jetë një institucion i besueshëm dhe i përgjegjshëm, që ofron shërbime të cilësisë së lartë dhe kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave publike.

Deklarata e Qëllimit:

1. **Menaxhimi efikas i burimeve financiare:** Sigurimi i një menaxhimi të efektshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare të komunës për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve publike.
2. **Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe administrative:** Ofrimi i shërbimeve profesionale dhe administrative për qytetarët dhe institucionet, duke siguruar një menaxhim të mirë të financave publike dhe zhvillimit ekonomik.
3. **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik:** Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, përfshirë mbështetje për bizneset, zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.
4. **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies:** Sigurimi i një administrate të hapur dhe të përgjegjshme, ku qytetarët kanë mundësi të informohen dhe të angazhohen në proceset vendimmarrëse dhe menaxhimin e financave publike.

Performanca :

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1 Paga dhe medijtje	196,510.89	196,510.89	199,510.89
2 Mallra dhe shërbime	46,137.00	76,696.00	76,696.00
3 Komunal	242,000.00	264,000.00	264,000.00
4 Subvenc. dhe tran.			
5 Kapitale			
TOTALI	484,647.89	537,206.89	540,206.89
Numri i te punesuarve	21	21	21

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1 Do të përgatiten raportet buxhetore-financiare mujore	12	12	12
2. Do te shpërndahen faturat mbi ngarkesën e tatimit në pronë,identifik.pronave te reja qe do ndikojn ne rritjen e nr.fakturave	23.000	24.000	25.000
3. Përpilimi dhe aprovimi i buxhetit vjetor dhe rishikimi për Organizatat buxhetore.			

Drejtoria për shërbime publike

Drejtori: Qendrim Millaku

Deklarata e Vizionit: Të krijojë një mjedis të sigurt dhe të pastër për qytetarët, duke ofruar shërbime publike të cilësisë së lartë dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Për të përmbushur obligime statutores të drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë këtë dhe arrijmë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat e tjera.
Deklarata e Misionit: Të ofrojë shërbime publike cilësore dhe të qëndrueshme për qytetarët, duke siguruar menaxhim efikas të burimeve dhe reagim të shpejtë në situata emergjente. Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët
Deklarata e Qëllimit: Mirëmbajtjen e rrugëve të komunës, ndriçimin publik dhe të rrugëve, mirëmbajtjen e kanalizimit dhe ujësjellësit..

Performanca :

Kategoritë ekonomike		2026	2027	2028
1	Paga dhe meditje	198,072.17	208,072.17	198,982.17
2	Mallra dhe shërbime	410,692.00	410,692.00	410,692.00
3	Komunali			
4	Transfere dhe subvencione			
5	Kapitale	645,000.00	290,000.00	600,000.00
	TOTALI	1,253,764.17	908,764.17	1,209,674.17
	Numri I te punesuarve	18	18	18
		2026	2027	2028
Kuantitative				
1. Mirëmbajtja e rrugëve urbane dhe rurale-		Gjatë tërë vititt	Gjatë tërë vititt	Gjatë tërë vititt
2. Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane —				
3. Mirëmbajtja e gjelbërimit – i parqeve.				
4. Mirëmbajtja e ndriçimit publik- oaza dhe ale.				
Kualitative				
1. Mundësitë e përmirësimit te mirëmbajtjes se rrugëve 2.mirëmbajtja verore .		“	“	“

Deklarata e Misionit: Planifikon, menaxhon dhe koordinon punën e zyreve të ZKK. Menaxhon stafin, objektet dhe buxhetin e ZKK.

Deklarata e Qëllimit: Qëllimi kryesor i kësaj zyreje është që të ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të gjitha komuniteteve të komunës me theks të posaçëm për minoritetet

Deklarata e Vizionit :Bashkëpunimi me komunitetet rreth çështjeve që kanë të bëjnë lidhur me kërkesat e Komuniteteve që adresohen ndaj qeverisjes lokale dhe që kanë të bëjnë me ofrimin e kushteve sa më të favorshme për një zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik, arsimor dhe kulturor për komunitetet dhe me këtë edhe të minoriteteve që jetojnë në komunën tonë, si dhe krijimin e kushteve jetësore për komunitetet.

Performanca :

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1 Paga dhe medijtje	39,274.32	39,274.32	39,274.32
2 Mallra dhe shërbime	2,000.00	2,000.00	2,000.00
3 Komunal			
4 Transfere dhe subvencione	3,000	3,000	3,000
5 Kapitale			
TOTALI	44,274.32	44,274.32	44,274.32
Numri i te punesuarve	4	4	4

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1 Ofrimi i ndihmës efikase për komunitetet e komunës dhe shërbimeve përkatëse në përmirësimin e pozitës së tyre , dhe mirqenje sa më të mirë, si dhe minoriteteve.	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit
Kualitative			
1. Bashkëpunimi me Drejtorin e F.E.ZH. dhe Sherb.Publike –gjetja donatoreve 6. Gjetja e donatoreve, dhe nese arrihet kjo, atëherë Komuna do participoj maximumi 20%.	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit

Deklarata e misionit: Të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit bujqësor dhe zonave rurale, duke ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për fermerët dhe komunitetet rurale. Të angazhohemi në implementimin e politikave zhvillimore, nxitjen e investimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në fshatra.

Deklarata e Vizionit: Të krijohet një komunë e zhvilluar dhe e qëndrueshme, ku bujqësia dhe zhvillimi rural janë motorë të rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale. Të arrihet një balancë midis zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës për qytetarët ruralë. Të krijojmë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të ujëra ve dhe digave, duke mbrojtur jetën dhe pasuritë e qytetarëve dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë. Do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

Deklarata e Qëllimit; Implementimi i politikave zhvillimore për bujqësi, koordinon dhe mbikëqyrë organizatat, asociacionet bujqësore, përgatit planin për të mbjellat vjetore dhe siguron që këto plane të implementohen. Koordinon punën me organet e qeverisë, përgatitjen dhe implementimin e politikave zhvillimore për rajonet rurale të Komunës.

Performanca :

Kategoritë ekonomike		2026	2027	2028
1	Paga dhe medijtje	52,942.71	52,942.71	52,942.71
2	Mallra dhe shërbime	8,000.00	8,000.00	8,000.00
3	Komunali			
4	Transfere dhe subvencione	231,000.00	231,000.00	231,000.00
5	Kapitale	130,000.00	120,000.00	120,000.00
	TOTALI	421,942.71	411,942.71	411,942.71
	Numri i te punesuarve	5	5	5

	2026	2027	2028
Kuantitative			
11. Përpilimi dhe përcjellja i mbjelljeve pranverore, vjeshtore.	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit
2. Përpilimi, raportimi, monitoringi i korrje-shirjeve, vjeljeve. grumbullimi i te mirave bujqësore.			
Kualitative			
1. Inkasomi i mjeteve nga shndrimi i tokës bujqësore ne jo bujqësore.	Mundesite buxhetore do shprehen edhe ne kualitetin e pikes 2	Mundesite buxhetore do shprehen edhe ne kualitetin e pikes 2	Mundesite buxhetore do shprehen edhe ne kualitetin e pikes 2
2. Realizimi i projekteve ne lëmin e bujqësisë			

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë

Drejtori : Nikson Daka

Deklarata e misionit: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër angazhohet në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe administrative për menaxhimin e pronës së paluajtshme, zhvillimin e sistemit kadastral dhe gjeodezik, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat urbane dhe rurale. Ajo kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës përmes ofrimit të shërbimeve efikase dhe të besueshme për qytetarët dhe institucionet.

Deklarata e Vizionit: Të krijohet një sistem i integruar dhe efikas i menaxhimit të pronës dhe zhvillimit hapësinor, i cili mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirëson cilësinë e jetesës për qytetarët. Drejtoria synon të jetë një institucioni i besueshëm dhe i përgjegjshëm, që ofron shërbime të cilësisë së lartë, transparente dhe inovative që kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e pronës dhe zhvillimin hapësinor.

Deklarata e Qëllimit: Përmes aplikimit të teknologjisë së përparuar si për gjeodetet ashtu edhe për zyrtarët përgjegjës për regjistrimin e pronës së paluajtshme në RDPP, po ashtu syhohet të rritet efikasiteti dhe kualiteti i shërbimeve kladastrale, e cila rezulton me pas me rritjen e të hyrave në DKGJP.

Performanca :

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1 Paga dhe medijtje	87,065.54	87,065.54	87,065.54
2 Mallra dhe shërbime	12,000.00	12,000.00	12,000.00
3 Komunal			
4 Subvenc. dhe transf.			
5 Kapitale	-	-	12,000.00
TOTALI	99,065.54	99,065.54	111,065.54
Numri i te punesuarve	9	9	9

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1.. Trajtimi i kërkesave të kadastrit	2000	2500	3000
Kualitative			
1. Trajtimi Kërkesave të kadastrit	2000	2500	3000

Drejtoria për Urbanizem, Planifikim Urban dhe Mjedis

Drejtori : Enver K. Berisha

Deklarata e misionit: Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit ka mision planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të territorit urban dhe rural, duke siguruar zhvillimin e infrastrukturës, ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Ajo angazhohet në hartimin dhe zbatimin e planeve hapësinore dhe urbanistike, lëshimin e lejeve të ndërtimit, si dhe mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe standardeve të mjedisit Mjedis natyror atraktiv të pastër tërheqës dhe përdorim më efektiv i tokës, infrastrukturë të planifikuar sipas standarteve Evropiane.

Deklarata e Vizionit: Të krijojmë një mjedis të organizuar, të gjelbër dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi urban dhe mbrojtja e natyrës janë të balancuara. Të kontribuojmë në ndërtimin e një komuniteti të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar për ruajtjen e resurseve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Mbajtjen e regjistrit të saktë të tokës, hartave dhe tokës tjetër dhe ndërtimin e bazave të të dhënave të ndërlidhura, do të përqijemi për të zhvilluar plane rregullore për përdorimin më efektiv dhe efikas të tokës dhe ndërtesave në të gjithë komunën e Klinës. Duke bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë e tjera ne dëshirojmë për të siguruar dhe arritur obligime statusore dhe ligjore, duke bërë që ato të jenë përmbushur në përputhje me plane të zhvilluara Urbane, dhe Planit Hapësinor edhe aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit. Me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe kryerjen e inspektimeve ne dëshirojmë që të sigurohet që zhvillimi dhe ndërtimi të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Brenda kësaj drejtorie ne gjithashtu bëjmë iniciativë dhe shpronësimit të tokës për të lehtësuar zbatimin në kohë dhe efektiv të projekteve të zhvillimit të infrastrukturës. Përveç kësaj ne ofrojmë Rregullore në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe të promovojmë respektimin e mjedisit dhe turizmit për të krijuar një komunë me ambient të pastër, të gjelbër dhe më tërheqës.

Deklarata e Qëllimit: Përmes aplikimit të teknologjisë së përparuar të rritet efikasiteti dhe kualiteti i shërbimeve mjedisore, konform saj edhe inkasimi i të hyrave nga kjo veprimtari.

Performanca :

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1 Paga dhe medijtje	65,448.44	65,448.44	65,448.44
2 Mallra dhe shërbime	63,200.00	63,200.00	63,200.00
3 Komunal			
4 Subvenc. dhe transf.			
5 Kapitale	2,861,798.00	3,924,838.00	4,114,527.00
TOTALI	2,990,446.44	4,053,486.44	4,243,175.44
Numri i të punësuarve	6	6	6

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1.. Trajtimi i kërkesave të urbanistike	1000	1000	1000
Kualitative			
1. Trajtimi Kërkesave të urbanistike	1000	1000	1000

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtori : Agron Bacaj

Deklarata e misionit:

Sigurimi i zbatimit të kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese, nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal. Të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore dhe të mbështesë mirëqenien sociale të qytetarëve të Komunës së Klinës, përmes:

- Organizimit dhe menaxhimit të shërbimeve shëndetësore në nivel primar dhe njësitë e tjera të kujdesit shëndetësor.
- Implementimit të projekteve dhe aktiviteteve për përmirësimin e kushteve të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale.
- Mbikëqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret në fuqi.

Deklarata e vizionit:

: Kujdesi për informimin shëndetësor, kujdesi esencial kurativ, dhe emergjent gjatë 24 orëve, shëndeti oral, shëndeti mendor, furnizimi me barna, kujdesi antenatal, kujdesi posnatal, planifikimi familjar, kujdesi paliativ etj. Të krijojë një sistem shëndetësor dhe të mirëqenies sociale të qëndrueshëm dhe efikas, ku:

- Qytetarët kanë akses të barabartë dhe të shpejtë në shërbime shëndetësore cilësore
- Shërbimet janë të orientuara drejt nevojave dhe kërkesave të komunitetit, duke siguruar përfshirje dhe pjesëmarrje aktive.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe cilësisë së shërbimeve është prioritet, përmes investimeve dhe inovacioneve.

Performanca :

SHENDETESIA PRIMARE:

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
Paga dhe meditje	1,521,370.81	1,527,370.81	1,534,370.81
Mallra dhe shërbime	450,000.00	450,000.00	489,441.00
Komunali	43,000.00	43,000.00	43,000.00
Subvenc. dhe transf.			
Kapitale	70,000.00	45,000.00	85,000.00
TOTALI	2,084,370.81	2,065,370.81	2,151,811.81
Numri I te punesuarve	147	147	147

QENDRA PER PUNE SOCIALE:

Kategoritë ekonomike	2026	2027	2028
1 Paga dhe meditje	103,408.77	103,408.77	103,408.77
2 Mallra dhe shërbime	12,000.00	12,000.00	12,000.00
3 Komunali	5,000.00	5,000.00	5,000.00
4 Subvenc. dhe transf.			
5 Kapitale			
TOTALI	120,408.77	120,408.77	120,408.77
Numri I te punesuarve	11	11	11

SHERBIMET RREZIDENCIALE

Kategoritë buxhetore	2026	2027	2028
1 Paga dhe meditje	127,510.06	127,510.06	127,510.06
2 Mallra dhe shërbime	45,000.00	65,000.00	65,000.00
3 Komunali	5,000.00	10,000.00	10,000.00
4 Subvenc. dhe transf.			
5 Kapitale	20,000.00		
TOTALI	197,510.06	202,510.06	202,510.06
Numri I te punesuarve	13	13	13

	2026	2027	2028
Kuantitative			
1. Edukimi shëndetësor	Tere vitin	Tere vitin	Tere vitin
2. Vaksinimi			
3. Diagnostifikimi i sëmundjeve			
4. Trajtimi i sëmundjeve			
5. Kujdesi paliativ			
6. Sistemi informativ shëndetësor			
7. Infrastruktura (24 Objekte)			
Subvencione për trajtim			

Kualitative			
1. Planifikimi	Niveli i kualitetit mvaret nga buxheti	Niveli i kualitetit mvaret nga buxheti	Niveli i kualitetit mvaret nga buxheti
2. SWOT Analiza-Analiza kërkimore			
3. Auditi Shëndetësor			
4. Hulumtimet			

Drejtoria Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtori: Driton Bardheci

Deklarata e Misionit: Të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të kulturës, rinisë dhe sporteve përmes:

- **Hartimit dhe implementimit të planeve strategjike** për mbështetje dhe zhvillim të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.
- **Udhëheqjes dhe menaxhimit të resurseve lokale**, përfshirë institucionet kulturore dhe sportive si teatri, biblioteka, muzeu dhe palestra.
- **Organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve**, si shënime të datave historike, debate, seminare dhe trajnime për avancimin e kulturës dhe rinisë.
- **Mbështetjes dhe promovimit të grupeve dhe individëve**, përfshirë regjistrimin e grupeve artistike, klubeve rinore dhe shoqatave sportive.
- **Sigurimit të resurseve të nevojshme**, duke përfshirë kërkimin e fondeve shtesë dhe investitorëve për mbështetje të aktiviteteve. Rritje e mbështetjes financiare për projekte rinore si dhe projekte që kanë për qëllim fuqizimin dhe pjesëmarrje aktive të vajzave/grave në shoqëri.

